

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

E-bulletin

Korrik, 2016

Takim me rëndësi në MASHT

SBASHK-u debatoi për shumë çështje me Ministrin Bajrami dhe Kabinetin e tij



Ministri i MASHT, Prof. dr. Arsim Bajrami bashkë me kabinetin e tij ka pritur në një takim pune kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe përgjegjësin për financa e administratë, Ymer Ymeri Delegacioni i SBASHK-ut ka shtruar në këtë takim një varg shqetësimesh që... (faqe 5)

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut mbajti takim të jashtëzakonshëm

Reagim i fuqishëm kundër testimit me shkrim të mësimdhënsve



Takimi ishte i hapur dhe mediet e kanë përcjellë atë me interesim të ... (faqe 6)

Një aktivitet ndërkombëtar i SBASHK-ut

**SBASHK I bashkëngjitet
Internationales Botërore
të Arsimit në solidaritet me
kolegët në Turqi**

Më 29 korrik sekretari i përgjithshëm i Internationales Botërore të Arsimit, z. Fred van Liven i ishte drejtuar ... (faqe 9)

Inervistë me kryetarin e Kuvendit të SAF në kuadër të SBASHK ,z. Murat Abazi

Abazi i gëzohet arritjeve në SBASHK

Murat Abazi është mësimdhënës i TIK. Ka punuar në disa shkolla dhe kudo ka lënë përshtypje të një pedagogu ... (faqe 4)

SBASHK-u afër përmbylljes me sukses të trajnimit për dialogun social

Pjesëmarrësit shprehen se ky është aktivitet i qëlluar



Këshilli Drejtues kishte vendosur që të vazhdohej me tranimet për dialogun social ... (faqe 7)

Editorial

Duhet hapur debat korrekt e pa tendenca për arsimin në Kosovë



Të hapim debat korrekt, të kulturuar e pa tendenca dhe bashkërisht të shohim ngecjet. Mësimdhënësi, i testuar a i pa testuar, vetëm nuk mund të ndryshojë gjendjen drejt cilësisë më të lartë. Duhet të përfshihemi e të angazhohemi të gjithë. Duhet angazhim i Ministrisë, DKA-ve, prindërve, inspektorëve të arsimit dhe më kryesorja duhet ta largojmë përfundimisht dhe plotësisht politikën nga shkollat.

Pas deklaratës së Ministrit Bajrami se në titorin e këtij viti të gjithë mësimdhënësit e Arsimit Parauniversitar do t'i nënshtrohen një testimt me shkrim dhe pas qëndrimit të argumentuar të SBASHK-ut kundër këtij eksperimenti është e natyrshme që të hapet një debat korrekt e pa tendenca për arsimin në Kosovë. SBASHK-u është i gatshëm të marr pjesë në këtë debat, qoftë në ndonjë Konferencë, qoftë në emisionet tematike e të debatit në TV-të tona të respektuara.

Mirë është të debatohet për gjendjen në arsim. Mirë

është edhe të jepen ide se si ta shtojmë cilësinë në arsimin tonë, por nuk është e natyrës intelektuale të flitet bazuar në inatin ndaj një mësimdhënësi dhe të thuhet se cilësia në arsimin tonë është shumë e dobët.

SBASHK-u ka pasur fatin të jetë i ftuar në shumë takime në shtetet e Ballkanit, të Evropës e madje edhe në Kanada. Kudo është bashkëbiseduar për çështje sindikale, por edhe për situatën aktuale në arsimin e vendeve pjesëmarrëse. Arsimi në Kosovë nuk është më i dobët nga cilësia krahasuar me vendet tjera në Ballkan. Mirëpo këtë arsimin tonë e dallon dhe e fisnikëron e kaluara historike dhe qëndresa e përkushtimi, pikërisht i këtyre mësimdhënësve që dikush me teste po mundohet t'i degradojë.

Këta mësimdhënësit tonë duke sakrifikuar jetën punuan në vitet e 90-ta për ta mbajtur gjallë shpresën për të ardhmen dhe janë nga më të merituarit për shtetësinë e Kosovës. As kërcënimi i pushuesit me dhunë e armë nuk i largoi këtë njerëz të mirë nga misioni i tyre për arsimimin dhe edukimin e brezave në ato kushte okupimi. Për këtë ata kanë marrë

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të viziton ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektonike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacionaal (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

për krahje e mirënjojhe edhe nga Internationalja Botërore e Arsimit dhe nga kolegët anëtarë të sindikatave simotra nga e Ballkanit, Evropa e bota. Këtë njerëz bashkë me koleget që iu shtuan lumi të mësimdhënësve të Kosovës në këto vitet e pasluftës janë të gatshëm të angazhohen edhe më shumë për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim, por jo përmes eksperimenteve të radhës e në bazë të tekave të individëve.

Ata që u plasi shpirti për testin në debate publike duhet të thonë e të tregojnë çka pas testit? Ata me siguri do të përgjigjen do të shohim dobësitë dhe do të rinisim me trajnime. A pak trajnime ka pasur në vitet e pasluftës te ne a? Ka pasur trajnime e trajnime dhe jo pak prej tyre, nuk janë mbajtur në shërbim të dijeve të reja e as në shërbim të ngritisës së cilësisë në arsim, por janë organizuar për qejfin dhe tekat e dikujt. SBASHK e përsërit vazhdimisht se është angazhuar e do të angazhohet me gjithë anëtarësinë

për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim përmes performancës dhe angazhimit të përbashkët me inspektorët profesionalë të arsimit.

Pra, të hapim debat korrekt, të kulturuar e pa tendenca dhe bashkërisht të shohim ngecjet. Mësimdhënësi, i testuar a i pa testuar, vetëm nuk mund të ndryshojë gjendjen drejt cilësisë më të lartë. Duhet të përfshihemi e të angazhohemi të gjithë. Duhet angazhim i Ministrisë, DKA-ve, prindërve, inspektorëve të arsimit dhe më kryesorja duhet ta largojmë përfundimisht dhe plotësisht politikën nga shkollat.

Unë si kryetar i SBASHK-ut në emër të gjithë mësimdhënësve të Kosovës e përmes këtij shkrimi po pranojë pjesëmarrjen në debate korrekte e të kulturuara me qëllim që bashkërisht të kontribuojmë për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim dhe për këtë nuk kemi nevojë për eksperimente e teste degraduese e ofenduese me shkrim për mësimdhënësit.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të viziton ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektonike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rrëth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rrëth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit International (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Inervistë me kryetarin e Kuvendit të SAF në kuadër të SBASHK ,z. Murat Abazi



Murat Abazi është mësimdhënës i TIK. Ka punuar në disa shkolla dhe kudo ka lënë përshtypje të një pedagogu të përkushtuar e të një kolegu shembullor. Është kryetari i SAF dhe anëtar i kryesisës së SBASHK-ut.

shtëpi e pa ndarë sot ka arritur rezultate të mëdha në nivel vendi dhe nivel evropian ku jemi anëtar dhe pse jo dhe nivel botërorë, si një bletë punëtore që din ti çmon dhe ruaj anëtarët e saj”, shprehet në inervistën e tij për gazeten “Arsimimi sot”, Murati.

1 Kush është Murat Abazi ?

Murat Abazi i është arsimtar i TIK-ut I lindur ne fshatin Skifteraj (Gjylekar) të komunës së Viti-së

I lindur më 08/05/1964 shkollën fillore e mbarova në fshatin Skifteraj , gjimnazin në Viti ndërsa fakultetin në degën e politeknikes në Prishtinë, në vitin 1985/86 fillova punën në shkollën fillore “Emin Duraku” si arsimtar i politeknikës në Skifteraj dhe Remnik, gjatë viteve 90 punova edhe si profesor i informatikës në shkollën e mesme “Kuvendi Lezhës” në paralelen e ndarë në Skifteraj dhe nga Viti 2000 punoj në shkollën fillore “Gjon Sereqi” në fshatin Mogilë dhe në Skifteraj.

Kam ndjekur trajnime të ndryshme të cilat më kanë ndihmuar që të jem një arsimtar I respektuar dhe me një përvojë të mirë metodo-pedagogjike.

2. Fillimet tuaja në SBASHK?

Anëtar i SBASHK-ut jam që nga themelimi. Në vitin 2008 jam zgjedhur kryetar i SBASHK-ut në shkollën fillore “Kenan Halimi”, ndërsa në vitin 2009 jam zgjedhur anëtar i kryesisë së degës ne Viti, e me vonë në Vitin 2011 jam zgjedhur kryetarë i arsimit të mesëm dhe fillor në Viti, më pas në kuvendin zgjedhor u zgjodha kryetar për arsimin fillorë të Kosovës dhe tani ushtroj këtë funksion në mandatin e parë. Kjo detyrë ma mundëson që të jem edhe anëtar i kryesisë së SBASHK-ut në nivel Republikan.

3. Si e shihni SBASHK-un sot. Angazhimi juaj si kryetar i Sindikatës se Arsimit Fillor dhe të Mesëm të Ultë të Kosovës?

Me plot besim të sigurt mund të them se SBASHK-u sot është shumë unik dhe i respektueshëm te anëtarësia e saj ku vet rritja e numrit të anëtarëve gjithnjë ne rritje tregon për besimin që ka te anëtarësia po ashtu edhe uniteti sindikal i dëshmuar në grevat që patëm. Një herit po ashtu dhe takimet e shpeshta të kryesisë dhe falë angazhimit të pa lodhshëm te kryetarit z. Rahman Jashari rrëgullisht takohemi dhe me kryetarët e arsimit fillor dhe të mesëm te ultë të Kosovës marrim pjesë në zgjedhjen e problemeve të tyre që kanë në nivele komunale.

Sqarojmë për punën tonë, angazhimin dhe përpjekjet për arritjen e qëllimeve, gjithnjë jamë aty ku e kërkon nevoja.

4. Jeni i respektuar nga të gjithë në SBASHK, si e keni arritur këtë?

Duke llogaritur në unitetin dhe respektimin ndër kolegjal gjithnjë në parimin të respektosh për të respektuar është arrit një frymë e kënaqësisë në punën dhe respektin në SBASHK andaj përfitojë nga rasti ti falënderoj të gjithë ata kolegë sindikalë për besimin e dhënë dhe bashkëpunimin e ndërsjellë sindikal, një

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

heri falënderoj ata të cilët e çmojnë dhe më kritikojnë në punën time.

5. Cilat arritje të SBASHK-ut do t'i veçoni dhe çka tutje?

Janë një varg i gjatë i rezultateve të arritura në SBASHK sidomos një numër i madh marrëveshjesh të arritura komunale e republikane në çdo komunë në shërbim të anëtarësisë dhe jemi në vazhdim të pa pritur që së bashku te shkojmë hap pas hapi dhe në realizimin e shumë kërkesave të anëtarësisë në rregullimin e mirëqenies së tyre, mund të themi me plot përgjegjësi që sot shumë kush e sheh veten të privilegjuar të jetë anëtar i SBASHK-ut, besoj qe

SBASHK-u po kryen punët e caktuara me të mundurën dhe të pa mundurën ka arritur një bashkëpunim të mirë edhe me MASHT-in në realizimin e shumë të drejtave të punëtorëve.

6. Porosia juaj për anëtarët e SBASHK-ut?

Nga vet emri SBASHK duhet llogaritur se vetëm të bashkuar mund të punojmë pa llogaritur interesat individuale ajo është një shtëpi e të gjithëve që e ndjenë veten anëtar të SBASHK-ut dhe kjo shtëpi e pa ndarë sot ka arritur rezultate të mëdha në nivel vendi dhe nivel evropian ku jemi anëtar dhe pse jo dhe nivel botërorë, si një bletë punëtore që din ti çmon dhe ruaj anëtarët e saj.

Gjatë muajit

Takim me rëndësi në MASHT

SBASHK-u debatoi për shumë çështje me Ministrin Bajrami dhe Kabinetin e tij

Ministri i MASHT, Prof. dr. Arsim Bajrami bashkë me kabinetin e tij ka pritur në një takim pune kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe përgjegjësin për financa e administratë, Ymer Ymeri Delegacioni i SBASHK-ut ka shtruar në këtë takim një varg shqetësimesh që janë ngritur nga anëtarësia e kësaj sindikate. Nga shqetësimet aktuale është edhe përfaljet se me implementim e Kurikulit të ri do të ketë zvogëlim të normave për lëndë të caktuara dhe me këtë paraqitet rreziku për mbetje të një numri mësimdhënësish pa vende pune. Ministri Bajrami bashkë me kabinetin e tij kanë garantuar SBASHK-un se për arsyet e Kurikulit të ri as një mësimdhënës nuk do të mbetet pa punë duke sqaruar se në një drejtim arsimor ka zvogëlim të fondit të orëve të një lënde, por ka edhe shtim të orëve të së njëjtës lëndë në drejtimin tjetër arsimor.



Në këtë takim të dy palët janë pajtuar për formimin e komisioneve që do të përgatisin tekstin e Kontratës së re Kolektive, pasi Kontratës aktuali i skadon afati në

prillin e vitit 2017. Është arritur pajtueshmëria që të shikohen përvojat e shteteve tjera nëse ka raste që të jetë punuar Kontratë Kolektive e përbashkët për të gjitha nivelet e arsimit dhe kështu bashkë me përfaqësues të SUSHK-ut-së do të përgatitej Kontrata e re

për të tri nivelet arsimore. Në këtë takim SBASHK-ka kërkuar angazhimin e Ministrit Bajrami në mënyrë që të arrihet të zgjidhja e kërkesave legjitime të stafit administrativ për Universitetit lidhur me Kontratën Kolektive, me bashkimin e pagës dhe pjesës stimulative dhe me realizimin e premtimit të vitit të kaluar nga Rektorati që punëtorët e administratës ta gëzojnë 0.5 % për çdo vit shërbimi edhe në pjesën stimulative. Ministri Bajrami dhe Kabineti i tij kanë premtuar se do të angazhohen brenda kompetencave që ka MASHT për të gjetur zgjidhje për këto kërkesa



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

që vijnë nga të punësuarit në UP.SBASHK-u ka marrë mbështetjen e Ministrit Bajrami dhe të MASHT edhe lidhur me përpjekjet që në amandamentimin e ligjit të Punës t'u mundësohet të punësuarve në arsim që të vazhdojnë me punën në arsim deri në mbyllje të vitit arsimor , pra që të mos largohen nga vendet e punës në ditën e pensionimit. Të dy palët janë pajtuar se kjo është në shërbim të nxënësve dhe të procesit arsimor, por është edhe e mbështetje për të punësuarit në arsim, për të cilët krijoen mundësi, pa u ngarkuar buxheti, që të marrin edhe dy pagat për muajt e vërës , pasi që qeveritë lokale nuk po realizojnë marrëveshjen lidhur me 3 pagat me rastin e pensionimit. SBASHK-u mori mbështetje dhe premtimin e MASHT se bashkërisht do të angazhohen edhe për procedimin e Projektligjit lidhur me statutin e mësimdhënësve të Kosovës për vitet 90-99.



Delegacioni i SBASHK-ut në këtë takim ka shtruar edhe çështjen e paralajmërimit publik të Ministrit Bajrami se në fillim të vitit të ri shkollor do të organizohet testim për mësimdhënësit e Arsimit Parauniversitar. SBASHK-u ka kërkuar sqarime nëse ky aktivitet ka bazë ligjore dhe se kush do të jenë përpiluesit , kush monitoruesit e testit dhe se cilat janë pritet dhe arsyet e një aktiviteti të tillë. SBASHK-u ka deklaruar në këtë takim se nuk bën të fillohet me një veprimi të tillë pa u sqaruar të gjitha shqetësimet e ngritura. Delegacioni i SBASHK-ut është deklaruar kundër iniciativës që mësimdhënësit t'i shtrohen një testi të tillë me shkrim duke e konsideruar këtë aktivitet si degradues për mësimdhënësit dhe përritjet e tyre gjatë gjithë studimeve.

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut mbajti takim të jashtëzakonshëm *Reagim i fuqishëm kundër testimit me shkrim të mësimdhënsve*

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka mbajtur më 8 korrik takim të jashtëzakonshëm. Kryetari i SBASHK-ut ka informuar përfaqësuesit e komunave të Kosovës dhe UP-së lidhur me situatën aktuale në arsim dhe veçmas lidhur me rrjedhën e takimit të 4 korrikut me Ministrin Bajrami dhe kabinetin e tij. Takimi ishte i hapur dhe mediet e kanë përcjellë atë me interesim të lartë.



Kryetari i SBASHK-ut bashkë me udhëheqësin për

financa dhe administratë, Ymer Ymeri kanë njoftuar Këshillin Drejtues lidhur me kërkesat që kanë shtruar në takim me Ministrin Bajrami. Ata kanë kujtuar se është biseduar për shqetësimet që janë ngritur në terren lidhur me frikën se me kurrikulin e ri mund të krijoen raste të mbetjes pa norma të plota apo edhe pa vende pune të punësuarve në arsim, e veçmas në gjimnaze dhe shkollat tjera të mesme. Jasharaj e Ymeri kanë përsëritur se kanë marrë garanci nga Ministri se me kurrikulin e ri nuk do të ketë probleme me normat e as nuk do të paraqiten dukuri të largimit, qoftë edhe të një individi nga vendi i tij i punës. Kryetari i SBASHK-ut, ka kujtuar se me Ministrin kanë biseduar edhe për shqetësimet në UP lidhur me Kontratën Kolektive të Universitetit, për unifikimin e pagës bazë dhe shtesës stimulative për administratën dhe për çështje tjera.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës



Ai pastaj është shprehur se çështje e nxeh të e debatuar me Ministrin ishte paralajmërimi i Ministrit për testimin me shkrim të mësimdhënësve në muajin tetor të këtij viti, ide të cilën delegacioni i SBASHK-ut e ka kundërshtuar duke i shtruar pyetjet Ministrit se : a ka bazë ligjore një veprim i tillë, kush do t'i përpilojë

testet e kush do t'i monitoroje, a do të testohen edhe drejtorët e shkollave dhe ata të DKA-ve ? e pyetje të tjera duke u shprehur qartazi kundër një testi të tillë.

“Ne jemi që të vlerësohet përforma e mësimdhënësve përmes hospitimeve dhe analizave të tjera, por kryesia e SBASHKU-t është kundër idësë për t'i testuar me shkrim mësimdhënësit ngase kjo konsiderohet si degradim i punës së tyre, degradim i dijes së arritur gjatë studimeve”, ishte qëndrim i Këshillit Drejtues. Nga ky takim doli përfundimi se :

“Ministria nuk ka kompetencë të vlerësojë dijen e mësimdhënësve sepse këtë dije e kanë vlerësuar profesorë të universiteteve gjatë gjithë viteve të shërbimit dhe studimit të mësimdhënësve”.

SBASHK-u afër përmbylljes me sukses të trajnimit për dialogun social

Pjesëmarrësit shprehen se ky është aktivitet i qëlluar

Këshilli Drejtues kishte vendosur që të vazhdohej me tranimet për dialogun social me qëllim që në këtë aktivitet të jenë të përfshirë mësimdhënës nga të gjitha komunat e Kosovës.



Ky vendim i Këshillit Drejtues është vënë në jetë dhe SBASHK-u është afër përmbylljes me sukses të këtij lloji të trajnimit. Në vazhdën e këtij aktiviteti ishte trajnimi me anëtarëve e SBASHK nga komunat e Shtimes, Dragashit e Junikut.

Fillimisht kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj ka folur për rëndësinë e këtij trajnimi i cilli synon të forcojë kapacitetet e SBASHK-ut për zhvillimin e suksesshëm të dialogut social duke filluar nga shoqata sindikale, niveli komunal e deri në atë qendror. Ai ka kujtuar edhe angazhimet konkrete të SBASHK-ut në realizimin e kërkuesave të anëtarësise dhe ka shprehur respektin për përkushtimin e pjesës më të madhe të të punësuarve në arsimin e Kosovës në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe për forcimin e unitetit në SBASHK..

Trajneri i licencuar për dialogun social Ymer Ymeri ka nisur me shpalosjen e temave kyçë të këtij trajnimi duke u ndalur te mënyra e udhëheqjes së dialogut social, te sfidat, pyetjet që shtrohen lidhur me dialogun social, për dialogun tre palësh në Kosovë e dy palësh në Evropë, për dialogun social në nivel lokal e qendror dhe për tema të tjera. Trajneri Ymeri me përkushtimin e tij ka bërë që trajnimi të ketë rrjedhë dinamike sepse pjesëmarrësit nuk janë në cilësinë e dëgjuesit e spektatorit, por janë pjesë aktive e këtij aktiviteti.

U mbajt takimi i radhës DKA, MASHT, SBASHK

SBASHK-u përsëriti se ka garanci nga MASHT se askush nuk do të mbeet pa vend pune

Pas një kohe të gjatë është mbajtur takimi i Drejtoreve të Drejtive Arsimore të Komunave të Kosovës , MASHT-it dhe përfaqësuesve të SBASHK-ut.



"Ky vit ishte një vit me plot sfida, por njëherësh vit i suksesshëm si rezultat i punës suaj, një vit i cili ka shënuar përpjekjet tona të vazhdueshme për ngritjen e cilësisë, përvendosjen e rregullit dhe rendit në shkolla dhe sigurimin e cilësisë", është shprehur një fjalën përshëndetëse Ministri Bajrami. Ai ka kërkuar nga përfaqësuesit e DKA-ve që të bëjnë me kohë gjithë përgatitjet me qëllim që edhe viti i ri shkollor të fillojë mbarë.

Delegacioni I SBASHK-ut ishte i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe përgjegjësi për financa e administratë , Ymer Ymeri.

Kryetari i SBASHK-ut në fillim të fjalës së tij është shprehur se SBASHK-u me kënaqësi ka pranuar lajmin se z. Agim Bërdyna është emëruar zv/Ministër në MASHT dhe ka shtuar se në bashkëpunim me të dhe me anëtarët tjerë të kabinetit të ministrit çështjet kanë mundësi shumë më të mëdha që të zgjidhen vazhdimisht me dialog. Kryetari Jasharaj u tha drejtoreve dhe të pranishmëve të tjerë që të mos nguten me shpalljen e konkurseve pa sistemuar gjithë mësimdhënësit që janë aktualisht duke punuar. Ai i ka

kujtuar DKA-të se ka pasur takime me Ministrin dhe me anëtarë të kabinetit të tij dhe ka marrë garanci se as edhe një i punësuar në sistemin arsimor nuk do të mbetet pa vend pune. Kryetari i SBASHK-ut , po ashtu, ka kujtuar DKA-të se janë të obliguar të thërrasin në panelet intervistuese për kuadro arsimore dhe përdrejtore edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut të nivelit komunal.



Zv/Ministri Agim Bërdyna ka shpalosur detyrat dhe aktivitetet që duhen zhvilluar nga Ministria dhe drejtoret arsimore në komunat e Kosovës me qëllim që të bëhen me kohë gjithë përgatitjet dhe që të bëhet shpërndarja me kohë e teksteve shkollorë. Nga përfaqësuesit e MASHT u tha se: "Sa i përket teksteve shkollorë u tha se janë rishikuar një numër i konsiderueshëm i teksteve për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët, të cilat janë në proces të ribotimit dhe do të janë të gatshme në fillim të vitit të ri shkollor". Këshilltari i Ministrit Bajrami, z. Osman Buleshkaj ka folur lidhur me pilotimin e Kurrikullit të ri duke theksuar se me kujdes është duke u përcjellë puna në shkollat pilot lidhur me kurrikulin dhe se të gjitha ëvrejtjet eventuale do të përfille.

Një aktivitet ndërkombëtar i SBASHK-ut

SBASHK I bashkëngjitet Internacionales Botërore të Arsimit në solidaritet me kolegët në Turqi

Më 29 korrik sekretari i përgjithshëm i Internacionales Botërore të Arsimit, z. Fred van Liven i ishte drejtuar SBASHK-ut dhe të 400 sindikatave tjera anëtarëre të EI-së, që numëron 32 milionë anëtarë, që të shprehim angazhimin dhe solidaritetin me kolegët tanë mësimdhënës nga sindikata Egitm – Sen, të cilët po përjashtohen nga Qeveria turke nga puna në mënyrë masive. Në letrën e z. Liven thuhet se EI ka marr informacione shqetësuese se deri tani janë suspenduar nga puna 15.200 kolegë tanë dhe i njëjti fat i pret edhe 6.538 të tjerë nëse nuk ndërpritet kjo fushatë ndëshkuese dhe e padrejtë ndaj tyre.

SBASHK-u duke u kyqur në këtë aktivitet ndërkombëtar ka nisur letra në adresën e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. Ban Ki-moon dhe në adresën e Ambasadores turke në Kosovë, znj. Kivilcim Kiliç. Nga z. Moon është kërkuar që ta ngrit zërin kudo në organet e OKB-së që të merren në mbrojtje kolegët tanë të persekutuar dhe që Turqia të obligohet të respektojë ligjet e saj dhe Konventat për

mbrojtjen e të Drejtave Elementare të Njeriut, nënshkruese e të cilave është edhe ajo. SBASHK-ut ka bërë publik këtë aktivitet përmes medieve të shkruara e elektronike, të cilat kanë publikuar informacionin dhe përbajtjen e letrës derguar Ambasadores së Turqisë në Kosovës, znj. Kivilcim Kiliç.

“Ju drejtohem në emër të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës ((UESCK – SBASHK) duke iu përgjigjur apelit të Internacionales Botërore të Arsimit dhe shumë të nderuarit Sekretar të Përgjithshëm të EI-së, z. Fred van Liven .

Ju drejtohami juve, e përmes jush edhe Qeverisë në Turqi, me kërkesën që të ndaloni përndekjen ndaj kolegëve tanë mësimdhënës dhe t'i riktheni në punë ata. Ju drejtohami të respektoni të Drejtat e Njeriut të parashikuara me Ligjet nationale dhe Konventat Ndërkombëtare, të cilat i ka nënshkruar edhe shteti Juaj”, është thënë në këtë letër.

Këshilli Shtetëror i Licencimit të Mësimdhënësve në punëtorinë 3 ditore

Tema kyçe: Licencimi, zhvillimi profesional dhe vlerësimi i përformancës së mësimdhënësve

Duke filluar më 14 korrik e për tri ditë me radhë këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve ka mbajtur punëtori me temat kyçe: Licencimi, zhvillimi profesional dhe vlerësimi i përformancës së mësimdhënësve.

Duke i shpallur të hapura punimet e kësaj punëtorie, zv. Ministri Agim Bërdyna ka folur për rëndësinë e temave që do të punohen në këtë punëtori dhe ka apeluar të pjesëmarrësit përkushtim maksimal.

Në këtë punëtori 3 ditore ishte pjesëmarrës edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili përfaqëson sindikatën tonë në KSHLM. Ai ka përgëzuar zv/Ministrin Bërdynë për përkushtimin në organizimin sa më të mirë të kësaj tryeze dhe ka apeluar që të punohet me zell në përfundimin e infrastrukturës ligjore e të dokumenteve përcjellëse në

mënyrë që procesi i licencimit të ri dhe përforma e mësimdhënësve të kryhet me sukses të plotë.

Kryetari i SBASHK-ut ka përsëritur edhe në seancën e parë të punës, por edhe gjatë punës në grupe qëndrimin kategorik të SBASHK kundër testit me shkrim për mësimdhënësit, të cilin Ministri Bajrami e kishte paralajmëruar si mundësi për në titorin e këtij viti. Kryetari Jasharaj këtë qëndrim të SBASHK-ut e ka mbrojtur me argumente të shumta edhe në seancat e punës, por edhe në takime të ndara me përfaqësues të Ministrisë dhe me pjesëmarrës të tjerë. “SBASHK-u është kundër idesë për t'i testuar me shkrim mësimdhënësit ngase kjo konsiderohet si degradim i punës së tyre, degradim i dijes së arritur gjatë studimeve, degradim degradim i titujve të fituar me dijen e dëshmuar para mësimdhënësve të universiteteve. Ministria nuk ka kompetencë të vlerësojë dijen e mësimdhënësve sepse këtë dije e kanë vlerësuar mësimdhënësit e universiteteve gjatë



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

studimeve të këtyre mësimdhënësve tanë. MASHT duhet të sigurojë mundësi dhe mekanizma për

hospitim dhe vlerësim të përformancës “, ka përsëritur kryetari Jasharaj.

Reagime nga Sindikatat Komunale

Sindikata e Arsimit Fillor dhe Sindikata e Arsimit të Mesëm në Podujevë përkrahin fuqishëm kundërshtimin e Këshillit të Përgjithshëm të SBASHK-ut lidhur me testin me shkrim përmësimdhënës të paralajmëruar nga Ministri i Arsimit i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këtë test eksperimentues mësimdhënësit llapjanë e vlerësojnë si një fyere në etikën profesionale të mësimdhënieς dhe degradim të dijes së arritur gjatë studimeve.

Sindikata e vlerëson performancën e mësimdhënësve përmes hospitimeve dhe analizave të tjera, por jo edhe testet e tillë me shkrim që degradojnë personalitetin dhe diplomat e tyre.

Ky test do të godas më së shumti mësimdhënësit që janë në prag të pensionimit disa prej të cilëve me vështirësi të mëdha shëndetësore po ecin deri në përfundim të misionit të tyre të arsimimit të gjeneratave te reja. Në vend të testeve të tillë eksperimentuese, mësimdhënësve të tillë do të mund t'u ndihmohej në forma tjera qoftë me shërbime më cilësore shëndetësore apo me ndonjë rregulllore të veçantë përpensionim të parakohshëm.

Të dy sindikatat në Podujevë shpresojnë se Ministria e Arsimit do të reflektoj drejtë dhe arsyeshëm përmorma të tjera të ngritjes së cilësisë në arsim që e ruajnë integritetin e mësimdhënësit, thuhet në komunikatën e nënshkruar nga kryetari i Sindikatës së arsimit fillorë dhe të mesëm, Fadil Halimi.

Dega e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit shkencës dhe Kulturës (SBASHK-u) në Deçan, kundërshton testimin e mësimdhënësve, që sipas tyre, është një lojë politike, se sa interesim përritje të cilësisë në arsim, ngase politika është ajo që ka ndikuar në gjendjen në të cilët gjendet arsimi sot. SBASHK-u kërkon nga institucionet e shtetit, qofshin lokale apo qendrore, që ti përmbushin premtimet e dhëna në krijimin e kushteve të mirëfillta përpunë,

sikurse të hjekin dorë nga punësimet politike në fushën e arsimit. Avdullah Lataj, kryetar i degës së Deçanit, ka thënë se punëtorët arsimor janë të gatshëm të përfillin çdo vendim që është në interes të ngritjes së cilësisë në arsim, por assesi të bëhet lojë me mësimdhënësit, që janë pjesa më e ndritur e historisë së Kosovës.

“Ku mbeti kurrikula shkollore që ende s’ka filluar në tërësi, sepse kjo është veç në fazën e pilotimit me mjaft probleme? Ku mbeti digjitalizimi i shkollave? Ku mbeti depolitizimi i shkollave? Ku është përvaja e mësimdhënësve gjatë viteve 89-99”, është shprehur Lataj, përtë cilin është mungesë e madhe mos funksionalizimi i inspektorati komunal i arsimit, që dikur kontrollonte secilin mësimdhënës përpunën e tij. Gjithnjë sipas kryetarit të SBASHK në Deçan, kërkosat e dala përtë testim të mësimdhënësve kanë përtë dështuar, sikurse që dështuan edhe në Shqipëri, që më tepër ishte i karakterit politik, se atij profesional. “Vizita e paradokohshme e ministres së arsimit të Shqipërisë në Kosovë, nuk ishte e rastësishme, ngase kërkoi që edhe Kosova të përfshihet në këtë vorbull, me qëllim të gjetjes së arsyetimit tek mësimdhënësit e tyre, e t’iu thuhet, “Ja edhe Kosova do i testoj mësimdhënësit e vet”, pa elaboruar mirë rezultatin përfundimtar, si dhe qëllimin e testimit!!!

“Mësimdhënësit duhet të kontrollohen, kritikohen, gradohen e lavdërohen, madje edhe të përjashtohen pëmos punë, por këto vlerësimë duhet kryer nga trupa profesionale dhe në mënyrë permanente, çdo orë, ditë dhe muaj, nëse dëshirojmë arsim cilësor”, kë nënvízuar në Avdullah Lataj, kryetar i Sindikatës së Arsimit në Deçan, përtë cilin defekti qëndron tek Qeveritë (lokale dhe qendrore), konkretisht te Ministria e Arsimit e Kosovës, ngase mësimdhënësit asnjëherë nuk pyeten veç përcështjet arsimore, por këtu ndërhyjnë dhe vendosin personat politik, dhe grupet rrëth tyre.

